



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.2.	PLUHURI DHE AGJENTËT KIMIKË
Nën-tema 2.2.5.	ATMOSFERAT SHPËRTHYESE
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Rregullore (MPMS) Nr.05/2016 për kërkesat minimale në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve nga risqet e atmosferave shpërthyes; • Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.10/2017 për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve nga risqet e lidhura me agjentët kimik në punë.
Shkurtesa:	• PPM – Pajisje Personale Mbrojtëse • MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje se mund ta këshilloni punëdhënësin të ndërmarrë veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNES			
	* Përgatituni për vizitën në lokacion. Nëse nuk i mbani mend kërkesat tuaja të brendshme, udhëzimet për punën në atmosferat shpërthyes, lexojini përsëri dokumentet për të qenë gati për vizitën në lokacion. * Kushtojini vëmendje shumëllojshmërisë dhe sasisë së kimikateve në vendet e punës. * Për shembull, rreziqet e substancave të rrezikshme dhe të atmosferave shpërthyes përfshijnë aktivitetet e mëposhtme: ruajtjen dhe përdorimin e ngjyrave të ndezshme me bazë të lëngshme; ruajtjen dhe përdorimin e oksigjenit; ruajtjen dhe transportimin e pluhurave në industritë farmaceutike dhe ushqimore; ruajtjen dhe shfaqjen e mallrave të ndezshëm, siç janë ngjyrat në dyqane; trajtimin dhe ruajtjen e tretësve të mbeturinave të ndezshme; punime saldimi ose punime të tjera të nxehta në rezervuarë dhe bateri që përmbajnë			

	<i>materiale të ndezshme; përdorimin e gazrave të ndezshëm, siç është acetileni, për saldim; përdorimin e tretësve të ndezshëm në laboratorë; transportimin e substancave të ndezshme në kontejnerë rreth një vendi të punës; dërgesat nga cisterna rrugore, siç janë lëngjet e ndezshme, gazrat dhe pluhurat në sasi të madhe; prodhimin, përpunimin dhe deponimin e kimikateve.</i>			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			
	<i>* Gjatë vizitës në lokacionin / vendin e punës kushtoni vëmendje nëse mjedisi i punës është i pastër, sistemi i ventilimit funksionon dhe mirëmbahet, nëse pluhuri i mbledhur asgjësohet siç duhet. Kushtojini vëmendje vetë procesit të punës.</i> <i>* Shumë vende pune mund të përmbajnë, ose të kenë aktivitete që prodhojnë atmosferë shpërthyesë ose potencialisht shpërthyesë. Shembujt përfshijnë vendet ku aktivitetet e punës krijojnë ose lëshojnë gazra ose avuj të ndezshëm, siç është spërkatja e ngjyrave të automjeteve, ose në vendet e punës që merren me pluhurat organikë të imët, siç janë mielli i grurit ose druri.</i> <i>* Vëzhgoni procesin e asgjësimit të mbeturinave dhe sigurohuni që ndiqen procedurat standarde të operimit.</i> <i>* Kontrolloni nëse të punësuarit kanë veshur PPM të përshtatshme dhe janë trajnuar për procedurat emergjente.</i> <i>* Jepni shembullin tuaj, përdorni PPM-të në varësi të rreziqeve që ekzistojnë në lokacion / vendet e punës!</i> <i>* Mbani shënime për vendet e vëzhguara të punës dhe bëni fotografi të proceseve. Kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë.</i> <i>* Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësorë, shpjegoni dhe këshillojini ata për rregullat e përgjithshme të sigurisë në punë ni miqësorë, shpjegoni dhe këshillojini ata për rregullat e përgjithshme të sigurisë në punë në një mjedis shpërthyes.</i> <i>* Përfundoni inspektimin duke ofruar një rekomandim përfundimtar për sigurinë dhe fushat për përmirësim.</i>			
1.	A janë identifikuar të gjitha zonat në të cilat mund të jetë e pranishme atmosfera shpërthyesë e gazit, në sasi të atilla që kërkojnë masa paraprake të veçanta?			

	Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 5			
2.	A janë identifikuar të gjitha zonat në të cilat reja e ndezshme e pluhurit është ose mund të jetë e pranishme në sasi të tilla që kërkojnë masa paraprake të veçanta? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 5			
3.	A janë identifikuar të gjitha zonat ku mund të ruhen, prodhohen ose trajtohen eksplozivët? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 5			
4.	A ka një diagram ose sinjal zonal që tregon qartë shtrirjen dhe natyrën e rrezikut në tre dimensionet? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 6			
5.	A janë i gjithë personeli që punon brenda ose afër rrezikut të vetëdijesuar dhe/ose e kanë trajnimin e duhur në lidhje me zonat e rrezikshme? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 6, Shtojca II <i>* Të gjithë të punësuarit duhet t'i dinë proceset, pyetini p.sh. A dinë si t'i përgjigjen një emergjence, çfarë të bëjnë nëse dëmtohet kabloja furnizuese e pajisjes elektrike? Nëse ata nuk e dinë, përsëritni trajnimin për SSHP.</i>			
6.	A është vendosur ventilim i mjaftueshëm që: • siguron shikueshmëri të mirë të operatorit? • parandalon vendosjen dhe akumulimin e pluhurit në dhomë? • redukton përqendrime të pluhurit? • parandalon kalimin e kontaminuesve në zonat e afërta të punës apo mjedis? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 4			

7.	A ekzistojnë metoda të pastrimit për të minimizuar retë e pluhurit, veçanërisht kur janë të pranishme burimet e ndezjes? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 4 <i>* Pyesni të paktën gjysmën e të punësuarve si e bëjnë pastrimin. Të punësuarit duhet t'i dinë procedurat e sakta të pastrimit të përditshëm në vendin e punës. Pastrimi nuk duhet të bëhet me anë të brushës, ajrit të kompresuar ose ndonjë metode tjetër që ngre pluhur, siç është fshesa e thatë, sepse kur pluhuri ngrihet në ajër duhet shumë kohë që grimcat e imëta të bien poshtë. Rekomandohet përdorimi i një fshese thithëse ose një metode të lagësht për t'i mbajtur pastër dyshemetë dhe sipërfaqet.</i>			
8.	A janë të lidhura dhe të tokëzuara të gjitha makinat që prodhojnë pluhur ose avull të ndezshëm, sistemet e gypave dhe kolektorët e pluhurit për të ulur akumulimin e ngarkesave elektrike statike? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 4 <i>* Kontrolloni të gjitha vendet e punës ku gjenerohet pluhur ose avull gjatë procesit të punës dhe verifikoni nëse sistemi i grumbullimit të pluhurit është i tokëzuar.</i>			
9.	A lejohet pirja e duhanit vetëm në zona të sigurta të specifikuara? A janë shënuar qartë zonat ku ndalohet pirja e duhanit me shenjat “Ndalohet pirja e duhanit”? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 4 <i>* Pyesni të punësuarit nëse pinë duhan dhe nëse po, ku e bëjnë atë. A pinë duhan gjatë pastrimit? Nëse po, përsërisni menjëherë trajnimin për SSHP.</i>			
10.	A janë vendosur shenjat e sigurisë (shenjat paralajmëruese, shenjat e detyrueshme) në përputhje me vlerësimin e riskut vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 6, Shtojca III			

Rregullore (MPMS) Nr.04/2016						
 Material i ndezshëm ose temperaturë e lartë	 Material shpërthyes	 Material toksik	 Material korroziv			
 Rrezik i përgjithshëm	 Material oksidues	 Atmosferat shpërthyesë	 Duhet të përdoren dorezat e sigurisë			
 Duhet të përdoren pajisje për mbrojtjen e veshëve	 Duhet të përdoren pajisje për frymëmarrje	 Duhet të vishen veshje mbrojtëse për tërë trupin	 Duhet të përdoren pajisje për mbrojtjen e fytyrës			
 Duhet të përdoren çizmet e sigurisë	 Duhet të përdoren pajisje për mbrojtjen e syve					

11.	A janë shënuar objektet e disponueshme të ndihmës së parë? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 6, Shtojca III Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 8 * <i>Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për objektet e ndihmës së parë nga disa pika të lokacionit. Nëse nuk mund t'i shihni shenjat, pyesni 2-3 punëtorë se ku ndodhen objektet e ndihmës së parë.</i> * <i>Kontrolloni nëse larja e syve dhe dushet janë në gjendje pune dhe lehtësisht të arritshme kur kërkohet.</i>			
	 <i>Dushi i sigurisë</i>	 <i>Pastrues për sy</i>		
INSPEKTIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË				
	* <i>Takohuni me përfaqësuesit e menaxhmentit (nëse është e mundur) dhe/ose ekspertët për SSHP.</i> * <i>Shpjegoni vëzhgimet tuaja të mira dhe jo të mira nga vizita në lokacion.</i> * <i>Në rast të mangësive të vëzhguara, sqaroni situatën (psh. të punësuarit nuk e pastrojnë rregullisht vendin e punës, nuk përdorin ventilimin e shkarkimit), kërkon dëshmi (p.sh. çdo dokument që tregon trajnimin e të punësuarve për përdorimin e duhur të PPM-ve).</i> * <i>Tregohuni miqësorë, sqaroni dhe këshillojini për detyrimet e tyre në lidhje me përdorimin dhe trajtimin e sigurt të kimikateve në atmosfera shpërthyes. Jepni shembuj të praktikës së mirë (p.sh. përfshirja e punëtorëve në kompani të tjera) nëse është e mundur.</i>			
12.	A përfshihen proceset e emetimit të pluhurit dhe avullit në vlerësimin e riskut në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 8			

	* Kontrolloni dokumentet e vlerësimit të riskut për të identifikuar ku, kur dhe pse është vëzhguar shkarkimi i pluhurit dhe avullit. * Kontrolloni a vlerësohet ekspozimi ndaj pluhurit dhe avullit sipas rrugës së hyrjes në trup (p.sh., nga frymëmarrja, gëlltitja, thithja përmes lëkurës), diskutoni me ekspertin për SSHP.			
13.	A janë marrë masa për të zvogëluar dhe parandaluar risqet e atmosferave shpërthyes? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, nenet 8, 9 Kontrolloni dokumentin e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse është kryer vlerësimi i masave të tjera parandaluese, diskutoni me ekspertin për SSHP. Verifikoni: * a keni procedura për situata të mundshme emergjente? * a keni shenja të duhura sigurie në vendet e punës nëse është e nevojshme? * a keni ventilim shkarkues nëse është i nevojshëm (a mirëmbahet rregullisht?)			
14.	A përdoret sistemi i zbulimit të shkëndijave dhe supresionit të shpërthimeve në sistemin e kolektorit të pluhurit (ose masa paraprake të ngjashme)? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Neni 4 * Kontrolloni specifikimet teknike të pajisjeve. * Kontrolloni nëse pajisjet kanë shënimet e servisimit të rregullt, merrni dhe mbani një procesverbal me shkrim për secilin rast servisi.			
15.	A i përfshijnë shënimet e trajnimit efektet shëndetësore, kontrollet, metodat e sigurta të punës dhe pajisjet/veshjet personale mbrojtëse? Rregullore (MPMS) Nr.05/2016, Shtojca II * Verifikoni dokumentacionin.			